



Newsletter

June 21st

Icon Tower (Kati 9)
Rr. Bekim Fehmiu 110,
10000 Prishtinë, Kosovë

www.oegjk.org

UPCOMING EVENTS IMPORTANT DATES



July 1

“Women Going Digital”

September 24


**“10 Years of the Berlin Process –
The Western Balkans as an Economic
Area on the Path to the EU”, BMWK
Conference Center in Berlin**

October 1

SUBEX, Pristina

October 2-3

**2nd German-Kosovar Economic Forum,
Pristina**



Newsletter
June 21st

Director's Note

**Të nderuar
anëtarë të Odës Ekonomike
Gjermano-Kosovare**

Në këtë edicion të Newsletter, ju sjellim përmbledhjen më të fundit të lajmeve të aktiviteteve tona dhe të partnerëve. Këto përfshijnë krijimin e Komitetit Drejtues të Koalicionit kundër Korrupsionit, programin e Mësimit Dual për vitin shkollor 2024/2025, tryeza e rumbullakët nga IOM, dëgjimin publik për Projektligjin për krypto-asete, zbritjen e ofruar nga AveHR në kuadër të #Member4Members, mundësi bashkëpunimi me OJQ TOKA dhe publikimi i broshurës "Trajtimi Tatimor i Furnizimeve Elektronike në Kosovë" nga ATK.

Ju falenderojmë që jeni pjesë e komunitetit tonë!

**Dear
members of the German-Kosovar
Business Association,**

In this edition of our newsletter, we bring you a summary of our latest news and activities, as well as updates from our partners. These include the establishment of the Steering Committee of the Anti-Corruption Coalition, the Dual Education program for the school year 2024/2025, the roundtable discussion by IOM, the public hearing for the Draft Law on Crypto-Assets, the discount offered by AveHR within the #Member4Members service, partnering opportunity with TOKA NGO and the publication of the "Tax treatment of Electronic Supplies" brochure by TAK.

We thank you for being part of our community!

Krijimi i Komitetit Drejtues të Koalicionit kundër Korrupsionit

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) gjatë kësaj jave ka qenë pjesë e krijimit të Komitetit Drejtues të Koalicionit Kundër-Korrupsionit në Kosovë. Qëllimi kryesor i këtij komiteti është të rrisë ndërgjegjësimin e komunitetit të biznesit për rëndësinë e zhvillimit të parimeve etike dhe integritetit të sektorit privat, me synim zvogëlimin e korrupsionit dhe përmirësimin të klimës së biznesit në vend.

Diskutimet u përqendruan në organizimin e komitetit, përgjegjësitë e anëtarëve dhe çështje të tjera thelbësore për funksionimin efikas të tij.

OEGJK mbetet e angazhuar për të kontribuar në krijimin e një mjedisi të ndershëm dhe transparent për bizneset në Kosovë.

Establishment of the Steering Committee of the Anti-Corruption Coalition

German –Kosovar Business Association (KDWW) has been part of the establishment of the Steering Committee of the Anti-Corruption Coalition in Kosovo this week. The primary goal of this committee is to increase awareness among the business community about the importance of developing ethical principles and integrity in the private sector, aiming to reduce corruption and improve the business climate in the country.

Discussions focused on the organization of the committee, responsibilities of its members, and other key issues essential for its effective functioning.

KDWW stays committed to contributing to the creation of an honest and transparent environment for businesses in Kosovo.



Oda Ekonomike e Kosovës fton bizneset të bëhen pjesë e Programit të Mësimit Dual për vitin shkollor 2024/2025

Oda Ekonomike e Kosovës fton të gjitha bizneset të bëhen pjesë e Programit të Mësimit Dual për vitin shkollor 2024/2025. Kjo nismë është krijuar për të ndihmuar në ndërlidhjen e arsimit me industrinë, duke u ofruar nxënësve të shkollave profesionale përvojë praktike dhe aftësi të vlefshme.

Duke marrë pjesë, kompanitë mund të zgjedhin profilet dhe numrin e nxënësve që dëshirojnë të mentorojnë, duke e përshtatur përvojën sipas nevojave të tyre specifike të fuqisë punëtore. Kjo është një mundësi unike për të formuar gjeneratën e ardhshme të profesionistëve dhe për t'u siguruar që ata janë të gatshëm për të përmbushur kërkesat e tregut modern të punës.

OEGJK e mbështet plotësisht këtë nismë, duke njohur rolin thelbësor të sistemit të arsimit dhe aftësimin profesional në zhvillimin e një fuqie punëtore të kualifikuar.

Mos e humbisni këtë mundësi për të investuar në fuqinë punëtore të së ardhmes. Plotësoni formularin e aplikimit këtu:

<https://forms.gle/qx8EGGW3sMqFk4Ye7>

The Economic Chamber of Kosovo invites businesses to participate in the Dual Education Program for the school year 2024/2025

The Economic Chamber of Kosovo invites all businesses to participate in the Dual Education Program for the school year 2024/2025. This initiative aims to bridge education with industry by offering practical experience and valuable skills to vocational school students.

By participating, companies can select the profiles and number of students they wish to mentor, tailoring the experience to their specific workforce needs. This is a unique opportunity to shape the future generation of professionals and ensure they are ready to meet the demands of the modern job market.

KDWW fully supports this initiative, recognizing the essential role of the vocational education and training system in developing a skilled workforce.

Don't miss out on this opportunity to invest in the workforce of tomorrow. Fill out the application form here: <https://forms.gle/qx8EGGW3sMqFk4Ye7>

Diskutim me sektorin privat: “Shfrytëzimi i Migracionit për Zhvillim”

Me datë 20 Qershor, u organizua tryeza e rrumbullakët "Shfrytëzimi i Migracionit për Zhvillim" organizuar nga International Organization for Migration (IOM).

Elena Elshani, përfaqësuese e OEGJK, së bashku me përfaqësues të shumtë të sektorit privat, theksuan rëndësinë e politikave integruese dhe rolin kyç të implementimit të programeve të arsimit dhe aftësimin profesional (VET) në eliminimin e hendekut mes aftësive dhe kërkesave të tregut të punës. Këto programe janë të domosdoshme si për shtetasit kosovarë, ashtu edhe për migrantët që vijnë në Kosovë.

Këto përpjekje sjellin përfitime të shumta për sektorin privat dhe për shtetin, duke rritur bashkëpunimin mes tyre. Kjo është duke u dëshmuar edhe përmes Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime, i cili ka për qëllim zhvillimin e dialogut publiko-privat dhe fuqizimin e ekonomisë së vendit.

Discussion with the Private sector: “Harnessing Migration for Development”

On June 20, the roundtable "Leveraging Migration for Development" was organized by the International Organization for Migration (IOM).

Elena Elshani, a representative of KDWW, along with numerous representatives from the private sector, emphasized the importance of integrative policies and the crucial role of implementing vocational education and training (VET) programs in bridging the skills gap and market demands. These programs are essential for both Kosovo citizens and migrants coming to Kosovo.

These efforts bring numerous benefits to the private sector and the state, increasing cooperation between them. This is also evidenced by the National Economic and Investment Council, which aims to develop public-private dialogue and strengthen the country's economy.

U mbajt dëgjimi publik për Projektligjin për krypto-asete

Me datë 20 Qershor u mbajt dëgjimi publik për Projektligjin nr. 08/L-295 për krypto-asetet në Kuvendin e Kosovës. Gjatë këtij dëgjimi, u shpalesën procedurat e deritanishme të projektligjit dhe u theksua rëndësia e marrjes së rekomandimeve, sugjerimeve dhe kritikave për përmirësimin e tij.

Në dëgjim publik morën pjesë përfaqësues nga Banka Qendrore e Kosovës (ATK), Njësia për Inteligjencë Financiare (NJIF), Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), KEDS, Dogana e Kosovës, OEGJK dhe përfaqësueses nga Odat e biznesit.

Pjesëmarrësit parashtruan pyetje lidhur me transparencën, autorizimin, dhe mbikëqyrjen e krypto-aseteve në Kosovë, kriteret e autorizimit dhe licensimit, ku u theksua rëndësia e Bankës Qendrore të Kosovës në licensim dhe mbikëqyrje të operatorëve.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit do të jenë Administrata Tatimore e Kosovës, Njësia për Inteligjencë Financiare dhe Banka Qendrore e Kosovës. Kushtet për dhënien e licencave dhe kohëzgjatjen e tyre do të rregullohen përmes Aktit Administrativ që do të hartojë BQK.

Afati për dorëzimin e komenteve për projektligjin është 27 Qershor, të cilat mund ti adresoni tek rreze.gashi@oegjk.org

Public Hearing held for the Draft Law on Crypto-Assets

On June 20, a public hearing was held for Draft Law No. 08/L-295 on crypto-assets in the Assembly of Kosovo. During this hearing, the current procedures of the draft law were presented, and the importance of obtaining recommendations, suggestions, and critiques for its improvement was emphasized.

Representatives from the Central Bank of Kosovo, Financial Intelligence Unit (FIU), Tax Administration of Kosovo (TAK), KEDS, Kosovo Customs, KDWW, and business chambers participated in the public hearing.

Participants raised questions regarding transparency, authorization, and oversight of crypto-assets in Kosovo, as well as the criteria for authorization and licensing. The importance of the Central Bank of Kosovo in licensing and supervising operators was highlighted.

The institutions responsible for implementing the law will be the Tax Administration of Kosovo, the Financial Intelligence Unit, and the Central Bank of Kosovo. The conditions for issuing licenses and their duration will be regulated through an Administrative Act to be drafted by the Central Bank of Kosovo.

The deadline for submitting comments on the draft law is June 27, which can be sent to rreze.gashi@oegjk.org



#Member4Members: Digitalizoni Burimet Njerëzore me AveHR

Nga pushimet e punëtorëve e deri te menaxhimi i inventarit – përmes AveHR mund t'i digjitalizoni Burimet Njerëzore.

AveHR është një platformë online e cila është gjithashtu lehtësisht e qasshme përmes aplikacionit mobil (App Store & Google Play Store). Kompanitë mund të regjistrohen, të caktojnë politikat e brendshme dhe të shtojnë të dhënat e punëtorëve. Të gjitha modulet dhe veçoritë e brendshme janë të modifikueshme sipas nevojës së secilit biznes, duke përfshirë edhe mënyrën se si aprovohet një vendim deri te lëshimi automatik i vendimit të pushimit përmes emailit.

Shërbimet që ofron platforma përfshijnë:

- Digjitalizimin e pushimeve të punëtorëve
- Digjitalizimin e dosjeve të punëtorëve
- Menaxhimin e Kalendarit të Festave Zyrtare
- Menaxhimin e Hyrjeve/Daljeve të punëtorëve
- Menaxhimin e aseteve/inventarit të kompanisë
- Thjeshtësimin e rekrutimit të kandidatëve të rinj
- Kalkulimin e pagave dhe benefiteve, etj.

Ofertë speciale për anëtarët e OEGJK: deri në 50% zbritje!

Për çdo informacion shtesë, mund të kontaktoni në info@avehr.com apo në numrin +383 48 500 331.

#Member4Members: Digitize Human Resources with AveHR

From employee vacations to inventory management – with AveHR, you can digitize your Human Resources.

AveHR is an online platform that is also easily accessible through the mobile app (App Store & Google Play Store). Companies can register, set internal policies, and add employee data. All modules and internal features are customizable according to the needs of each business, including the way a decision is approved to the automatic issuance of vacation approval via email.

The services offered by the platform include:

- Digitizing employee vacations
- Digitizing employee files
- Managing the Official Holidays Calendar
- Managing employee check-ins/check-outs
- Managing company assets/inventory
- Simplifying the recruitment of new candidates
- Calculating salaries and benefits, etc.

Special offer for KDWW members: up to 50% discount!

For additional information, you can contact us at info@avehr.com or call +383 48 500 331.

TOKA është organizata #1 e vullnetarizmit në Kosovë dhe ata kanë nevojë për mbështetjen tuaj!

Në fillim të këtij muaji ju treguam për kampet verore të TOKA-s, ku të rinjtë zbulojnë veten dhe bëhen më të pavarur. Megjithatë, TOKA bën shumë më tepër përmes aktiviteteve jo-formale. Ata implementojnë Klube të Vullnetarizmit Edukativ, Ditën e Solidaritetit dhe Çmimet e Vullnetarizmit të Vitit për të rinjtë dhe përkrahësit e tyre në Kosovë dhe më gjerë.

[Klubet e Vullnetarizmit Edukativ](#), të njohura edhe si "Klubet e Super-Vullnetarëve," janë nisma më me ndikim në nivel lokal e arritur nga TOKA. Çdo klub përbëhet nga 25 të rinj që takohen çdo javë për të mësuar më shumë për veten, komunitetin dhe për të planifikuar dhe zbatuar një projekt të Vullnetarizmit Edukativ. Këto klube, të shpërndara në 20 komuna, kryesisht në zona rurale, transformojnë të rinjtë në qytetarë aktivë dhe ndihmojnë në përmirësimin e komuniteteve. Deri më tani, ato kanë pasur mbi 15,000 anëtarë, kanë ngritur më shumë se 40,000 € për projekte në komunitet dhe kanë fituar çmime ndërkombëtare për ndikimin e tyre.

TOKA: The #1 Volunteer Organization in Kosovo Needs Your Support!

At the beginning of this month, we told you about TOKA's summer camps, where young people discover themselves and become more independent. However, TOKA does much more through non-formal activities. They run Educational Volunteering Clubs, Solidarity Day, and the Volunteer of the Year Awards for youth and their supporters in Kosovo and beyond.

[Service Learning Clubs](#), also known as "Super-Volunteer" Clubs, are TOKA's most impactful local initiative. Each club consists of 25 young people who meet weekly to learn about themselves, their community, and to plan and implement an Educational Volunteering project. These clubs, spread across 20 municipalities, mostly in rural areas, transform young people into active citizens and help improve communities. So far, they have had over 15,000 members, raised more than €40,000 for community projects, and won international awards for their impact.

[Dita e Solidaritetit](#) është një program rekord-thyes në vitin 2023 për TOKA-n! Në këtë ditë, të rinjtë punojnë në një biznes dhe kompensimi i tyre shkon në Fondin e Ditës së Solidaritetit, që mbështet projekte rinore. Është një mundësi e shkëlqyer për të rinjtë që të fitojnë përvojë pune, të kontribuojnë në komunitet dhe të përmirësojnë mundësitë e tyre të punësimit, me 20% të vullnetarëve që marrin oferta pune. Dita e Solidaritetit ka filluar në Prishtinë dhe është zgjeruar në 8 komuna, duke përfshirë 635 vullnetarë, ngritur 9,226 € dhe bashkëpunuar me 55 biznese.

[Çmimet e Vullnetarizmit të Vitit](#) janë iniciativa më e re e TOKA-s, që synon të njohë dhe mbështesë kontributet e individëve për ta bërë Kosovën një vend më të mirë. Përmes këtyre çmimeve, TOKA synon të njohë ndikimin e të rinjve, bizneseve, diasporës, figurave publike, mësuesve, komunave dhe grupeve joformale dhe OJQ-ve. Thirrja për nominime është e hapur deri më 15 shtator, prandaj nëse njihni dikë që meriton një falenderim për kontributin e tyre, klikoni [këtu](#) për të nominuar.

Ndikimi i TOKA-s është i mundur falë ndihmës së donatorëve, individëve dhe bizneseve në Kosovë dhe ndërkombëtarisht. Për të ndihmuar, shikoni Paketën e Partneritetit [këtu](#), ose kontaktoni drejtpërdrejtë me TOKA-n përmes info@toka-ks.org ose +383 38 704 560.

[Solidarity Day](#) is a record-breaking program in 2023 for TOKA! On this day, young people work at a business, and their compensation goes to the Solidarity Day Fund, supporting youth projects. It's a great opportunity for young people to gain work experience, contribute to their community, and improve their employment prospects, with 20% of volunteers being offered jobs. Solidarity Day started in Pristina and has expanded to 8 municipalities, involving 635 volunteers, raising €9,226, and partnering with 55 businesses.

[Volunteer of the Year Awards](#) is TOKA's newest initiative, recognizing and supporting the contributions of individuals making Kosovo a better place. Through these awards, TOKA aims to acknowledge the impact of youth, businesses, the diaspora, public figures, teachers, municipalities, and informal groups and NGOs. Nominations are open until September 15, so if you know someone who deserves a pat on the back for their contribution, click [here](#) to nominate.

TOKA's impact is made possible by the support of donors, individuals, and businesses in Kosovo and internationally. To help, see the Partnership Packages [here](#), or contact TOKA directly at info@toka-ks.org or +383 38 704 560.



ATK publikon broshurën "Trajtimi Tatimor i Furnizimeve Elektronike në Kosovë"

Më datë 21 Qershor, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka publikuar broshurën "Trajtimi Tatimor i Furnizimeve Elektronike". Ky publikim synon të edukojë individët që të përmbushin vullnetarisht obligimet e tyre tatimore që rrjedhin nga Furnizimet Elektronike. Ai ofron udhëzime rreth trajtimit të aktiviteteve elektronike për qëllime tatimore, duke adresuar operatorët ekonomikë dhe qytetarët të angazhuar në tregti elektronike.

Broshura përfshin tema si aktivitetet ekonomike elektronike, dallimet mes tregtisë tradicionale dhe tregtisë elektronike, detyrimet e furnizuesve elektronikë dhe aspektet e TVSH-së lidhur me vendndodhjen e furnizimit. Ajo thekson kërkesat ligjore për operatorët ekonomikë elektronikë në Kosovë për të regjistruar, mbajtur dokumentacion, deklaruar dhe paguar tatimin. ATK inkurajon respektimin e këtyre detyrimeve për të evituar gjokat, duke nxitur një qasje moderne ku detyrimet tatimore janë pjesë e qeverisjes ekonomike të Kosovës.

Broshura, e mbështetur nga Programi për Qeverisje Ekonomike i USAID-it në Kosovë, është e disponueshme [online](#) (aktualisht vetëm në gjuhën shqipe) në faqen e ATK-së në seksionin "[Fletëpalosje dhe Broshura](#)" dhe së shpejti do të jetë në dispozicion edhe në formë fizike. Për informacione shtesë, vizitoni www.atk-ks.org.

TAK has published the "Tax treatment of Electronic Supplies" brochure

On June 21, the Tax Administration of Kosovo (TAK) has published the "Tax Treatment of Electronic Supplies" brochure. This publication aims to educate individuals to voluntarily fulfill their tax obligations arising from electronic supplies. It provides guidance on how electronic activities are treated for tax purposes, addressing both economic operators and citizens engaged in electronic commerce.

The brochure covers topics such as electronic economic activities, distinctions between traditional and electronic trade, obligations of electronic suppliers, and VAT aspects related to supply locations. It emphasizes the legal requirement for electronic economic operators in Kosovo to register, maintain documentation, declare, and pay taxes. TAK encourages compliance to avoid penalties, fostering a modern approach where tax obligations are integral to Kosovo's economic governance.

The brochure, supported by the USAID Economic Governance Program in Kosovo, is accessible [online](#) (currently only in Albanian) via TAK's website under "[Flyers and Brochures](#)" and will soon be available in physical form. For detailed information, visit www.atk-ks.org.

YOUR
CONTACT PERSON
AT KDWW

Monday / Friday
08:30 – 16:30

BOOK
YOUR APPOINTMENT
AT KDWW-OEGJK

Icon Tower (Kati 9)
Rr. Bekim Fehmiu 110,
10000 Prishtinë, Kosovë




Koordinatorë

Coordinator

**Department
for Advocacy and
Government Relations**

Rreze Gashi

rreze.gashi@oegjk.org



Icon Tower (Kati 9)
Rr. Bekim Fehmiu 110,
10000 Prishtinë, Kosovë

www.oegjk.org